



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*

*Zyra e Kryeministrit / Ured Premijera*  
*Office of the Prime Minister*  
*Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje*  
*Office on Good Governance*

# STRATEGJIA PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

2019-2023



Ky publikim është realizuar në kuadër të Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Jo-diskriminuese të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, me përkrahje të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë.

Janar 2019

# STRATEGJIA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS

2019-2023 është hartuar nga:

**Qëndresa Ibra- Zariqi** - Zyrtare e Lartë për të Drejtat e Fëmijëve, Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZQM/ZKM).

## me kontributet e Grupit Punues:

**Habit Hajredinit** - Drejtor në ZQM/ZKM

**Alberita Hyseni** - ZL/ZKM

**Adnan Ahmeti** - ZPS/ZKM

**Merita Jonuzi & Imrane Ramadani** – MASHT

**Lulzim Beqiri & Armen Mustafa** – MD

**Sherife Sekiraqa** - MBPZhR

**Selvete Sadiku** – MPMS

**Merita Vuthaj** – MSh

**Merita Berisha** - IKShP

**Kadrie Myrtaj & Faketa Kuka** – MAPL

**Azem Reqica** – MF

**Hysni Shala** – PK

**Igballe Rrahmani** – IAP

**Dren Rexha** – UNICEF

**Donjeta Kelmendi**- KOMF

**Donat Rexha** – UNICEF

**Dea Pallaska** – Save the Children

Falënderim i veçantë iu dedikohet përfaqësuesve të UNICEF, Save the Children, Terre des Homes, Qendra për Arsim e Kosovës, Këshillit Rinorë të Kosovës, Grupit monitorues për realizimin e të drejtave të fëmijëve – Respect our Rights (ROR), Zyrës së Bashkimit Europian në Kosovë, UNDP, GIZ për mbështetjen e vazhdueshme përgjatë hartimit të dokumentit strategjik.

Përzemërsisht, falënderojmë përfaqësuesit institucional, përkatësisht Zyrën për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Agjencia e Statistikave të Kosovës; Asociacionin e Komunave dhe të gjitha Ministritë e linjës kontributet e të cilëve mundësuan pasurimin e dokumentit Strategjik me të dhëna dhe validimin e tij.

## Përmbajtja

<b>1.0 Përmbledhje ekzekutive</b> .....	9
<b>2.0 Hyrja</b> .....	12
<b>3.0 Metodologjia</b> .....	13
<b>4.0 Sfondi</b> .....	15
4.1 Ekonomia .....	17
4.2 Arsimi .....	18
4.3 Shëndetësia .....	21
4.4 Mbrojtja dhe Përfshirja Sociale .....	25
4.5 Pabarazia .....	30
<b>5.0 Objektivat Strategjike dhe objektivat specifike</b> .....	32
5.1 Objektiva strategjike #1: Përmirësimi i qeverisjes së mirë për realizimin e të drejtave të fëmijëve .....	32
5.2 Objektiva strategjike #2: Përmirësimi i qeverisjes lokale për realizimin e të drejtave të fëmijëve .....	33
5.3 Objektiva Strategjike #3: Përfshirja dhe fuqizimi i fëmijëve në vendimmarrje .....	34
5.4 Objektiva Strategjike #4: Gjithëpërfshirja e fëmijëve në shërbime të integruara për edukim dhe zhvillim në fëmijërinë e hershme .....	35
5.5 Objektiva Strategjike #5: Përmirësimi i shëndetit, mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve për arritjen e potencialit të tyre të plotë.....	35
<b>6.0 Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit</b> .....	37
6.1 Mekanizmat zbatues .....	39
6.2 Mekanizmat monitorues .....	39
<b>7.0 Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i strategjisë</b> .....	40
<b>8.0 Ndërlidhja e Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve me SDG (Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm)</b> .....	42

## Shkurtesat

AAK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
MIN	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTI	Ministria e Industrisë dhe Tregtisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MSA	Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit
NEET	Të rinjtë as në punësim, as në arsim dhe as në trajnim
QAP	Qendrat e Aftësimi Profesional
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
ZPS	Zyrës për Planifikim Strategjik të Zyrës së Kryeministrit
PRE	Programin e Reformave Ekonomike
KDF	Konventën për të Drejtat e Fëmijës
KASH	Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve
SDG	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm/Sustainable Development Goals
ROR	Respect our Rights



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/87  
Datë: 29.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 janar 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve 2019-2023 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve 2019-2021.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit koordinon dhe monitoron zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

*“Është mjaft e qartë se mes dashurisë dhe mirëkuptimit është një lidhje shumë e fortë... ai që dashuron kupton, dhe ai që kupton dashuron. Dikush që ndihet i kuptuar ndihet i dashuruar nga të tjerët dhe dikush që ndihet i dashuruar ndihet i sigurt se e kanë kuptuar. Madje, mirëkuptimi është më i thellë se njohuria. Dikush mund të na njohë ne, por janë të paktë ata që na kuptojnë. Mos u mundo të kuptosh gjithçka. Nuk është e thënë që disa gjëra duhet të kuptohen, ato thjesht duhet të pranohen. Gjithë urrejtja është dhimbje, ndërsa gjithë dhembshuria është mirëkuptim.”*

**(Breror Rexha, nxënës në kl. VIII, shkolla fillore e mesme e ultë, “Faik Konica”)**



# 1.0 Përmbledhje ekzekutive

Po aq sa është e vërtetë se fëmijët nesër do të trashëgojnë botën që ne ua lamë sot, është gjithashtu e rëndësishme të rikujtojmë se botën nesër do ta trashëgojnë fëmijët e sotëm. Vendimet politike të bëra sot përcaktojnë nëse miliona fëmijë dhe të rinjë janë në gjendje të arrijnë potencialin e tyre të plotë, ose ti lënë të përballen me një të ardhme të përkeqësuar, të pabarabartë dhe të marginalizuar. Si pasojë, ata përcaktojnë botën që ne do të shohim nesër<sup>1</sup>.

Fëmijët ndërtojnë themelet e jetës dhe të ardhmes së shtetit, andaj kërkohet angazhim kuptimplotë i komunitetit për të zhvilluar një të rritur të edukuar, arsimuar, shëndoshë dhe produktiv. Megjithatë, është po ky aset i pazëvendësueshëm shtetëror që shpeshherë nuk merr vëmendjen e duhur në përputhje me interesin më të mirë të tyre, përfshirë ndarjen më të ulët të burimeve financiare nga qeveria.

Prandaj, në kuadër të Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve për vitin 2019-2023 të Republikës së Kosovës, zhvillimi i kapitalit njerëzor është përcaktuar si faktor thelbësor kontribues për rritjen ekonomike, rrjedhimisht në kuadër të strategjisë si synim specifik është rritja e mirëqenies së fëmijëve. Të bindur se investimi në fëmijë është rruga e duhur dhe e vetme për ndërtimin e një bote paqësore, të qëndrueshme dhe prosperuese, Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar ti bashkëngjitet rrugëtimit të vendeve pro-perëndimore drejtë përmbushjes së obligimeve të përcaktuara në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, si dhe të traktateve e standardeve të tjera ndërkombëtare.

Për t'iu përgjigjur sfidave vendore e ndërkombëtare, por edhe në linjë të përmbushjes së obligimeve të shteteve palë<sup>2</sup> të përcaktuara në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF), konkretisht neni 4 i cili thekson se: “Palët Shtetërore duhet të ndërmarrin të gjitha masat e duhura legislative, administrative dhe masat tjera për zbatimin e të drejtave të njohura në këtë Konventë”, Qeveria ka aprovuar<sup>3</sup> Strategjinë dhe Planin Nacional të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2009-2013. Dokumenti strategjik dedikuar fëmijëve identifikonte çështjet që me prioritet kishin nevojë për

---

<sup>1</sup> UNICEF, 2012. Right in Principle and in Practice: A Review of the Social and Economic Returns to Investing in Children. New York.

<sup>2</sup> Ju lutem vini re që, edhe pse Kosova për shkak të statusit të saj politik para OKB nuk mund të ratifikojë Konventën për të Drejtat e Fëmijës, ajo ka inkorporuar KDF në Kushtetutë që përbën pikën më të gjerë të referencës ligjore dhe vazhdon të tregojë përkushtim për implementimin e Konventës. Për këtë arsye, kjo pjesë i referohet jurisprudencës së Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, si dhe tekstit të Konventës, si udhëzim për Kosovën në realizimin e të drejtave të fëmijës.

<sup>3</sup> Vendim 07/69, dt. 19.06.2009.

ndërhyrje të menjëhershme duke bërë përpjekje maksimale që t'iu sigurohet fëmijëve mbrojtje dhe kujdes i nevojshëm për mirëqenien dhe zhvillimin e tyre. Në vazhdim të këtij procesi, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në suaza vjetore ka hartuar 'Raportet e Progresit', që kishin për qëllim monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit Nacional të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve. Raporte këto që theksonin çështjet kryesore lidhur me të drejtat e fëmijëve dhe progresin e bërë gjatë zbatimit të strategjisë, dhe njëherit janë cilësuar si e arritur e institucioneve qeveritare edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë.

Të përkushtuar që Republika e Kosovës të jetë një nga vendet më të mira për fillim të shëndoshë të jetës, për të jetuar fëmijët dhe për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë, të drejtat e fëmijëve po bëhen çdo herë e më shumë pjesë e agjendës të zhvillimit të politikave kombëtare dhe kuadrit ligjor e institucional, me ç'rast Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit mori Vendim<sup>4</sup> për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2021.

Strategjia për të drejtat e fëmijëve është vazhdimësi e strategjisë paraprake<sup>5</sup>, komponentë që rrjedhë nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2021), e bazuar në parimet dhe dispozitat e Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Strategjisë së Këshillit të Europës për të Drejtat e Fëmijës (2016-2021), Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) me BE-në, Strategjisë për përmirësimin e planifikimit dhe koordinimit të politikave në Kosovë (2017-2021), traktateve e standardeve të tjera ndërkombëtare. Gjithashtu, është në përputhje me masat e parapara në strategjitë e sektorëve që ndërlidhen me Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (2017-2021), Programin e Reformave Ekonomike (PRE) 2018-2021 të miratuar nga Qeveria e Kosovës si dhe me angazhimet e Kosovës ndaj Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs). Si e tillë, karakterizohet nga qasja e saj unifikuese dhe gjithëpërfshirëse, e shtrirë në të gjitha nivelet qeverisëse duke promovuar dhe respektuar të drejtat e fëmijës, bazuar në parime të rrënjosura<sup>6</sup> në Konventë.

Me anë të dokumentit strategjik synohet të vendoset një kornizë gjithëpërfshirëse e politikave dhe njëherit të shërbejë si bazament për strategjitë e tjera nën-sektoriale, në mënyrë që të ndikojë në masën më të madhe të mundshme në unifikimin e përpjekjeve institucionale në kuadër të reformimit të sistemit në tërësi, veçanërisht sistemit që i referohet të drejtave të fëmijëve. Politika

---

<sup>4</sup> Vendim ref.116/2016, të dt. 20.10.2016

<sup>5</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategy\\_Narrative\\_-\\_Shqip03\[1\].pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategy_Narrative_-_Shqip03[1].pdf)

<sup>6</sup> Komenti i Komitetit të Përgjithshëm të KDF-së Nr.5 'Masat e përgjithshme të implementimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (nenet 4, 42 dhe 44, para. 6), para 28.

këto që i referohen ciklit jetësor të fëmijës, duke përfshirë kujdesin para lindjes, gjatë foshnjërisë, fëmijërisë dhe adoleshencës, duke priorizuar fëmijët më të marginalizuar. Reforma këto që nuk do të kishin kuptim në rast se nuk do të reflektoheshin në frymën gjithëpërfshirëse, me qëllim ndërmarrjen e nismave për të përmirësuar gjendjen e fëmijëve në kontekstin ekonomik, social dhe politik.

**Vizion ky që do të arrihet me përmbushjen e objektivave Strategjike, si:**

Objektiva strategjike #1:	Objektiva strategjike #2	Objektiva strategjike #3	Strategic Objective #4	Objektiva strategjike #5
Përmirësimi i qeverisjes së mirë për realizimin e të drejtave të fëmijëve;	Përmirësimi i qeverisjes lokale për realizimin e të drejtave të fëmijëve;	Përfshirja dhe fuqizimi i fëmijëve në vendimmarrje;	Gjithëpërfshirja e fëmijëve në shërbime të integruara për edukim dhe zhvillim në fëmijërinë e hershme;	Përmirësimi i shëndetit, mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve për arritjen e potencialit të tyre të plotë

Përmbushja e këtyre objektivave do të kontribuojnë në arritjen e synimeve nacionale të përcaktuara sipas qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë (SDGs). Objektivat strategjike janë në përputhje dhe kontribuojnë në qëllimin kryesor të Agjendës 2030 që bënë thirrje për zhdukjen e varfërisë në të gjitha format dhe eliminimin e pabarazive (SDGs 1<sup>7</sup>, 5<sup>8</sup> dhe 10<sup>9</sup>), rritjen e mundësive të të gjithë fëmijëve që të kenë sukses në të arriturat arsimore (SDGs 4<sup>10</sup>), shërbime kualitative shëndetësore dhe sociale (SDGs 2<sup>11</sup> dhe 3<sup>12</sup>), parandalimin e dukurive negative dhe dëgjimi i zërit të tyre (SDGs).

Rëndësia e përmbushjes së objektivave strategjike dhe investimit në fëmijë është e shumëfishtë, përveçse është gjëja e duhur për tu bërë, në aspekt të planifikimit të politikave afatgjate drejtë përmirësimit të pozitës aktuale të shtetit, është investim ekonomik me vlera të mëdha në kthim. Investimi në krijimin e kushteve për zhvillim cilësor të fëmijës në fëmijërinë e hershme, krijon parakushte për investime më ekonomike në zhvillimin e tyre në periudhat e mëvonshme jetësore,

<sup>7</sup> Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj në secilin vend;

<sup>8</sup> Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave;

<sup>9</sup> Ulja e pabarazisë në kuadër të shtetit dhe midis shteteve;

<sup>10</sup> Shëndet i Mirë dhe Mirëqenie - Të sigurohet jetë e shëndetshme dhe të promovohet mirëqenia për të gjithë, në të gjitha moshat;

<sup>11</sup> Zhdukja e urisë, të arrihet sigurimi i ushqimit dhe të ushqyerit e përmirësuar si dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme;

<sup>12</sup> Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë për të gjitha moshat;

si fëmijë apo individë të rritur. Por, rëndësia e investimit të shtetit në fëmijë ka peshë të veçantë jo vetëm në kuptim të sigurimit së fëmijës jashtë varfërisë por gjithashtu është një mënyrë efikase dhe kosto efektive e sigurimit se brezat e tashëm të fëmijëve bëhen qytetarë të rritur duke qenë të shëndetshëm, produktiv dhe aktiv.

Për të arritur rezultatet e synuara kërkohet dyfishim i përpjekjeve institucionale (në nivel qendror dhe lokal), organizatave jo qeveritare vendore e ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës, për të ndërtuar një bazë për zhvillim më të qëndrueshëm dhe të barabartë në të ardhmen, si dhe për të bërë këto të drejta një realitet për të gjithë fëmijët.

## 2.0 Hyrja

Fëmijët janë pasuria më e madhe e shtetit të ri të Kosovës, aspiratat e të cilit janë që së shpejti të jetë edhe zyrtarisht/formalisht anëtare me të drejta të barabarta në Bashkimin Europian. Që ky aset jashtëzakonisht i rëndësishëm të zë vendin e merituar në shoqëri, Qeveria e Republikës së Kosovës është mobilizuar që të ndërtojë dhe fuqizojë sistemin dhe mekanizmat institucional për zbatim dhe monitorim të të drejtave të fëmijëve.

Qasja strategjike është ndërtuar bazuar në elementet thelbësore të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në, zotimet nacionale dhe globale për arritjen e synimeve për zhvillim të qëndrueshëm (SDGs) dhe në funksion të zbatimit dhe respektimit të parimeve demokratike dhe të drejtave të fëmijëve siç janë shpallur në Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe përcaktimit të tyre në politikat dhe legjislacionin vendor.

Hulumtimet tregojnë se përkundër progresit të arritur, të drejtat e fëmijëve shkelen/cenohen në baza ditore, ka ende boshllëqe në mbrojtje ligjore të fëmijëve, hendeku rritet edhe më shumë në mes ligjit dhe praktikës/zbatueshmërisë. Rezultate këto që ndikuan në marrjen e nismës për hartimin e strategjisë, proces ky që ka përfshirë në vete orientimin e masave dhe politikave që në mënyrë përkatëse pasqyrojnë parimet e KDF, standardet politike dhe ekonomike të BE-së, si dhe rekomandimet e evidentuara në Raportet e Progresit për të drejtat e fëmijëve dhe Kartën Raportuese. Të gjitha këto elemente janë integruar në mënyrë të konstruktuar për të përkrahur njëra tjetrën në përmbushjen e misionit të përbashkët, fëmijëve t'u ofrohet hapësira e nevojshme për zhvillimin e potencialit të plotë të tyre. Njëherit, kontribimit dhe realizimit të

prioriteteve/ambicieve ekonomike, sociale dhe politike të Qeverisë. Nevoja për hartimin e strategjisë rrjedhë nga konkluzionet e dala nga takimi<sup>13</sup> i Komitetit Ndërmëtor për të Drejtat e Fëmijës<sup>14</sup>. Ndërkaq, për të realizuar në mënyrë progresive të drejtat e fëmijëve në Kosovë, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZKM) në bashkëpunim me UNICEF-in, fillimisht morën iniciativën të vlerësojnë Strategjinë dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2009 – 2013. Të interesuar që vlerësimi i zbatimit të dokumentit strategjik të jetë sa më i paanshëm, ai është realizuar nga “Coram Children’s Legal Centre” me seli në Londër, duke u thirrur dhe reflektuar Raportet e Progresit për Fëmijë, vëllimi I<sup>15</sup>, II<sup>16</sup>, III<sup>17</sup> dhe IV<sup>18</sup>, si dhe ofrimin e rekomandimeve për zhvillimin e strategjisë<sup>19</sup>. Vlerësimi i raporteve të sipër cekura i ka paraprirë hartimit të strategjisë, duke vënë në pah relevancën, rëndësinë, efektshmërinë, ndikimin, pronësinë dhe qëndrueshmërinë e orientimit të politikave qeveritare në mënyrë strategjike. Realizimi i të drejtave të njeriut, fillon me investimin në fëmijë, rezultatet e të cilit janë të ndërlidhura në nivel të lartë të produktivitetit për ekonomin, gjendjen sociale dhe zhvillimin e vendit. E ardhmja e një shteti varet shumë nga fakti nëse qytetari i saj është i shëndetshëm dhe i arsimuar. Andaj, pavarësisht vështirësive me të cilat vazhdon të përballet shteti, investimi në fëmijë është gjëja e duhur dhe e domosdoshme për tu bërë drejt prosperitetit të mirëqenies së fëmijëve dhe realizimit të të drejtave të tyre, gjithnjë në shërbim të zbehjes dhe eliminimit të po atyre vështirësive.

### 3.0 Metodologjia

Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve është hartuar duke u bazuar në një metodologji të kombinuar në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirëse, të adresojë prioritetet kyçe bazuar në evidencë dhe të siguroj që intervenimet e përcaktuara do të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike. Përgjatë procesit të hartimit të dokumentit strategjik janë organizuar punëtori dhe takime individuale me aktorët kyç vendor dhe ndërkombëtarë, para së gjithash konsultime me përfaqësuesit e fëmijëve nga Këshillat e Nxënësve në nivel vendi dhe grupit monitorues për realizimin e të drejtave të fëmijëve – Respect our Rights (ROR). Për të siguruar përfshirjen e të gjithë akterëve kyç, është krijuar grupi punues për hartimin e kësaj strategjie. Pas analizës së gjendjes aktuale, janë përcaktuar

---

<sup>13</sup> Konkluzionet e Komitetit Ndërmëtor për të Drejtat e Fëmijëve, më:31.05.2013;

<sup>14</sup> Vendim Nr.07/46, të dt. 03.12.2008;

<sup>15</sup> [www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Raporti\\_shqip\\_final.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Raporti_shqip_final.pdf);

<sup>16</sup> [www.kryeministri-ks.net/.../raporti\\_i\\_vleresimit\\_2011\\_SPNVDF.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/.../raporti_i_vleresimit_2011_SPNVDF.pdf);

<sup>17</sup> [www.kryeministri-ks.net/.../Raportit\\_i\\_Progresit\\_shqip\\_Final.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/.../Raportit_i_Progresit_shqip_Final.pdf);

<sup>18</sup> [www.kryeministri-ks.net/.../Progresi\\_i\\_Raportit\\_ALB\\_01\\_web.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/.../Progresi_i_Raportit_ALB_01_web.pdf);

<sup>19</sup> Raport për Zhvillimin e Strategjisë, Coram Children’s Legal Centre – Coram;

objektivat strategjike, objektivat specifike, aktivitetet dhe veprimet konkrete, të cilat janë buxhetuar.

Në aspektin strukturor dhe përmbajtësor “Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve 2019-2023 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve 2019-2021 është hartuar në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ (QRK) nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, Rregulloren e Punës së Qeverisë Nr.09/2011 dhe Rregulloren (QRK) Nr.05/2016 për Standardet minimale për procesin e Konsultimit Publik. Procesi i hartimit të strategjisë ishte i ndarë në tri faza: 1) faza e parë është karakterizuar me analizimin e situatës së përgjithshme, si dhe realizimin e një serie të takimeve konsultative<sup>20</sup>, në të cilat kanë qenë të përfshirë fëmijët dhe akterët relevant që punojnë në nivel lokal; 2) përgjatë fazës së dytë Ekipi<sup>21</sup> përgjegjës për hartimin e strategjisë ka analizuar dokumentet strategjike në fuqi<sup>22</sup>, raporte e vlerësime të ndryshme vendore e ndërkombëtare dedikuar fëmijëve, veçanërisht Raportet e Progresit të KE, Raportet e Progresit për të drejtat e fëmijëve<sup>23</sup>, Karta Raportuese<sup>24</sup>, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG)<sup>25</sup>, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS)<sup>26</sup>, Korniza ligjore për të Drejtat e fëmijëve në Kosovë<sup>27</sup>, Analiza e situatës së të drejtave të fëmijëve<sup>28</sup>, Kosova në fazën e hershme të dividendit demografik, një mundësi me kohë të kufizuar<sup>29</sup>, Analiza e situatës mbi Kujdesin dhe Zhvillimin gjatë Fëmijërisë së Hershme<sup>30</sup>, Një Agjendë për Fëmijë<sup>31</sup>, Indeksi i Mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë<sup>32</sup>, Zëri Ynë<sup>33</sup>, Varfëria dhe privimi në mesin e fëmijëve me përdorimin e Analizës së Privimeve të Shumëfishta (MODA)<sup>34</sup>, etj. Ndërsa, në fazën e tretë dokumenti i është nënshtruar procesit të konsultimeve publike, ekipi punues ndër-institucional ka shqyrtuar dhe inkorporuar inputet e pranuar dhe sipas legjislacionit në fuqi është proceduar për aprovim.

---

<sup>20</sup> Raporti përmbledhës i takimeve konsultative në komunal për përcaktimin e fushave prioritare të SPVDF (2016-2020);

<sup>21</sup> Vendim ref.116/2016, të dt. 20.10.2016;

<sup>22</sup> [http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Regjistri\\_i\\_dokumenteve\\_strategjike\\_ne\\_fuqi\\_.pdf](http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Regjistri_i_dokumenteve_strategjike_ne_fuqi_.pdf)

<sup>23</sup> Shif referencat si më lartë;

<sup>24</sup> <http://www.kryeministri-ks.net>;

<sup>25</sup> <https://www.un.org/sustainabledevelopment>;

<sup>26</sup> <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/anketa-e-grupimeve-te-treguesve-te-shumefishte>;

<sup>27</sup> [https://www.unicef.org/kosovoprogramme/Legal\\_FW\\_Shqip.pdf](https://www.unicef.org/kosovoprogramme/Legal_FW_Shqip.pdf);

<sup>28</sup> [https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/CRSA\\_Kosovo\\_2013%20December\\_2.pdf](https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/CRSA_Kosovo_2013%20December_2.pdf)

<sup>29</sup> UNICEF. 2016. Kosova në fazën e hershme të dividendit demografik – një mundësi me kohë të kufizuar;

<sup>30</sup> [https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Analiza%20e%20situates\\_ALB%20me%20cover%20page.pdf](https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Analiza%20e%20situates_ALB%20me%20cover%20page.pdf);

<sup>31</sup> [www.unicef.org/kosovoprogramme/Agenda\\_for\\_Children\\_SHQIP.pdf](http://www.unicef.org/kosovoprogramme/Agenda_for_Children_SHQIP.pdf);

<sup>32</sup> <http://www.komfkosova.org/rekomandimet-e-indeksit-te-mbrojtjes-se-femijes-2-0/?lang=en>;

<sup>33</sup> [https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Young%20Voices%20Report\\_alb.pdf](https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Young%20Voices%20Report_alb.pdf);

<sup>34</sup> [https://www.unicef.org/kosovoprogramme/MODA\\_SHQIP.pdf](https://www.unicef.org/kosovoprogramme/MODA_SHQIP.pdf);

## 4.0 Sfondi

Të jesh fëmijë në Kosovë nuk është aspak e lehtë. Kriza politike dhe pasojat e luftës së viteve të nëntëdhjeta kanë bërë që të rrenohet i tërë sistemi shtetërorë, vështirësitë rriten tutje me zgjatjen e tranzicionit të shtet formimit nëpër të cilin po kalon vendi pas shpalljes së pavarësisë (2008). Kjo situatë aspak e favorshme ka ndikuar që fëmijët të pësojnë “tranzicion të dyfishtë”, duke i bërë ata që periudhën e artë të jetës, zhvillimin nga moshë e fëmijërisë në moshë madhore, ta kalojnë edhe duke bartur peshën e pasigurisë politike dhe zhvillimit të qëndrueshëm të saj.

Mirëpo, faktet mbi potencialin që posedon Republika e Kosovës, bëjnë që të shohim dritën e daljes nga tuneli. Aseti më i rëndësishëm dhe vendimtarrës për të ardhmen e vendit janë fëmijët. Fatmirësisht, 30 % e popullsisë së Republikës së Kosovës është e përbërë nga fëmijët nën moshën 18 vjeç, përderisa 47% e popullsisë nën moshën 25 vjeç<sup>35</sup>, përqindje kjo që favorizon Kosovën në krahasim me të gjitha vendet Europiane, duke bërë që mos të mbajë barrën e popullsisë së moshuar siç po ndodhë në vendet e BE.

Zhvillimi i kapitalit njerëzor do të jetë faktor kontribues me rëndësi për rritjen ekonomike në të ardhmen e afërt dhe të largët, ndërsa cilësia e kapitalit njerëzor në dispozicion do të jetë një nga përcaktuesit kryesor të suksesit ekonomik<sup>36</sup>.

Thënë ndryshe, kujdesi ndaj të sapolindurve, fëmijëve dhe adoleshentëve sot, është parakusht që Kosova nesër të jetë e përgatitur për një mjedis konkurrues të ndërtuar në bazë të shkathtësive<sup>37</sup> e inovacioneve teknologjike. Rëndësia e investimit në fëmijë kalon përmasat e argumenteve ekonomike, duhet të shihet edhe në kontekst të zhvillimit të qëndrueshëm social e politik. Literatura thekson se investimi në fëmijë është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave të tyre, që mundëson plotësimin e qëllimeve të gjera shoqërore dhe njëherit garantues për sigurimin e mirëqenies shtetërore.

Përveç argumenteve të dëshmuara, rëndësia që Qeveria e Republikës së Kosovës të marr të gjitha masat legislative, strategjike, administrative e të tjera të nevojshme për të vënë në jetë të drejtat e garantuara të fëmijëve, është dyfish më e lartë se në vendet tjera, për faktin se Kosova tashmë ka

---

<sup>35</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2014. Parashikimet e Popullsisë 2011-2061, varianti i mesëm;

<sup>36</sup> Varfëria dhe privimi në mesin e fëmijëve me përdorimin e Analizës së Privimeve të Shumëfishta (MODA);

<sup>37</sup> Ju lutem vini re: “shkathtësi” i referohet përshkrimit siç është në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim;

hyrë në fazën e parë të “dividentit demografik”, që është nxitje e produktivitetit ekonomik që ndodhë kur pjesa e fuqisë punëtore (popullsia e moshës 15-64 vjeç) është më e madhe se pjesa vartëse apo popullsia jo-punuese e moshës 0-14 vjeç dhe më të vjetër se 65 vjeç<sup>38</sup>.

Dividenti demografik njihet si një dritare e mundësisë për përshpejtimin e rritjes ekonomike, e cila nuk hapet në mënyrë automatike, kjo varet plotësisht nga kapitalizimi i mundësive dhe zbatimi i politikave efektive. Për të përfituar dhe maksimizuar të mirat e kësaj mundësie është vendimtare që investimet të orientohen në kapitalin njerëzor, fëmijë, duke zbatuar politika efektive në adresimin e sfidave dhe mundësive në veprime adekuate<sup>39</sup>.

Bazuar në të gjeturat e raporteve të monitorimit për të drejtat e fëmijëve, që njëherit pasqyrojnë situatën aktuale sa i përket të drejtave të fëmijëve në Republikën Kosovë duke ofruar informata mbi treguesit kyç të cilët janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin vendor, Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (të njohur si SDG) dhe Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (të njohura si MCC), rezultojë se janë bërë përmirësime të ndjeshme duke evidentuar arritjet më të rëndësishme, përfshirë: uljen e vazhdueshme të vdekshmërisë së fëmijëve dhe foshnjave, njohjen dhe mbrojtjen më të mirë të të drejtave të fëmijëve, programi i imunizimit gjithëpërfshirës, vijueshmëri e lartë e fëmijëve në arsimin e fillor dhe me trend të rritjes së atij parashkollor, progres në ngritjen e gjithëpërfshirjes në arsim, reformimi i sistemit të drejtësisë për fëmijë, ndikimi në zvogëlimin e jobarazive të përgjithshme. Të arritura këto, të cilat janë në hap me agjendën dhe përpjekjet globale dedikuara fëmijëve.

Megjithatë, mbetet ende shumë për t’u bërë për të përmirësuar mirëqenien e fëmijëve dhe nxitjen e përparimit shoqëror. Midis të tjerash, ka nevojë të punohet për të kaluar pasojat e dëmshme të të keqshqyerit drejt sigurimit të plotë të mjediseve të shëndetshme për fëmijë, për të lehtësuar qasjen në kujdesin shëndetësor, për të hetuar arsyet dhe ndaluar efektivisht rastet e përfshirjes së fëmijëve në punë të rënda dhe të rrezikshme, për të tejkaluar dështimin në arritjet shkollore dhe për të arritur rezultatet e duhura arsimore për ta.

Lidhja ndërmjet pozitës së pafavorshme ekonomike dhe përjashtimit social është evidentuar dukshëm në zonat rurale ku qasja për shërbimet kryesore publike, në shëndetësi apo arsim, shpesh

---

<sup>38</sup> Lee, R., and Mason, A. (2006) What is the Demographic Dividend? Finance and Development, 2006;

<sup>39</sup> UNICEF. 2016. Kosova në fazën e hershme të dividentit demografi – një mundësi me kohë të kufizuar;



është e vështirë, madje edhe e pamundur. Përderisa, përjashtimi social, kryesisht i fëmijëve të komunitetit Romë, Ashkalinj dhe Egjiptas përbën një sfidë në vete.

## 4.1 Ekonomia

Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm (SDG) bëjnë thirrje për eliminimin e varfërisë në të gjitha format e saj deri më 2030<sup>40</sup>. Përkundër përpjekjeve dhe arritjes së progresit në disa fusha, Republika e Kosovës vazhdon të ballafaqohet me një numër të konsiderueshëm të sfidave, sfida këto që janë drejtpërdrejtë të ndërlidhura me nivelin e zhvillimit, normat e larta të papunësisë dhe varfërinë. Kosova është një nga vendet më të varfra në Europë, me 17.6 % të popullsisë që jetojnë në varfëri të përgjithshme dhe 5.2 % të popullsisë që jeton në varfëri ekstreme<sup>41</sup>.

Nivel të lartë të papunësisë, veçanërisht në mesin e të rinjve me 53.3 %<sup>42</sup>, përderisa norma e tërësishme e popullsisë joaktive<sup>43</sup> është 56.5 %<sup>44</sup>. Sipas përlllogaritjes së rritjes ekonomike dhe mundësisë për të hyrë në tregun e punës për vit, nga 30,000 të rinj që futen në tregun e punës vetëm 15,000 punësohen<sup>45</sup>.

Duke qenë se Kosova ka popullsinë më të re në Europë, kjo situatë bëhet edhe më komplekse, ngase i bie të ballafaqohet me atë që quhet “rrezik i trefishtë”: të qenit i ri, i papunë dhe jashtëzakonisht i varfër. Kështu që, popullsia e re e Kosovës po aq sa paraqet mundësi, mund të paraqet sfida dhe rreziqe. Kësaj shtate të pavolitshme i duhet shtuar edhe faktin se fuqia punëtore në Kosovë ka probleme edhe me shkallën e shkathtësisë dhe kompatibilitetin e saj me tregun e punës, e cila ia dobëson përparësinë që ka sa i përket faktit se është ndër më të rejtat në Evropë<sup>46</sup>. Situata përkeqësohet tutje, për faktin se 27.4%<sup>47</sup>, apo mbi një e treta e kosovarëve të rinj nuk janë as në arsim as në punë dhe rrezikojnë të jenë “gjeneratë e humbur”.

---

<sup>40</sup> UN.2015. Sustainable Development Goals (SDGs) – Agenda 2030;

<sup>41</sup> ASK. 2017 TM3. Raporti i Varfërisë;

<sup>42</sup> ASK. 2017 TM3. Anketa e fuqisë punëtore;

<sup>43</sup> Vërejtje: “Popullsi joaktive” i referohet popullsisë në moshë pune, që nuk janë të punësuar e as të lajmëruar si të papunë;

<sup>44</sup> ASK. 2017 TM3. Anketa e fuqisë punëtore;

<sup>45</sup> BB.2014. Rishikimi i financave publike të Kosovës- Politikat fiskale për një shtet të ri;

<sup>46</sup> QHDNJIE dhe QDNjUP. 2011. Politikat Sociale në Kosovë- Skemat sociale dhe përshtatshmëria e tyre me realitetin kosovar;

<sup>47</sup> ASK. 2017 TM3. Anketa e fuqisë punëtore;

Edhe për ata me arsim më të lartë, perspektiva për gjetjen e një vendi pune duket se janë duke u përkeqësuar, me disa të dhëna që sugjerojnë një numër në rritje të të papunëve me diploma universitare<sup>48</sup>.

Fatmirësisht mundësitë që Kosova të tejkaloj këto sfida janë të larta. Ngase, nuk ballafaqohet me presionet fiskale dhe ekonomike që rezultojnë nga një popullsi në vjetrim, një problem ky me të cilin ballafaqohen shumë nga vendet tjera të Europës lindore<sup>49</sup>. Mirëpo, urgjentisht duhet që politikat për shpenzime publike të sigurojnë përputhshmëri me nevojat e popullsisë së re dhe ndërmarrjeve që veprojnë në Kosovë. Patjetërsueshëm, fokusi duhet të vihet në mirë edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, si dhe aftësimin e fuqisë punëtore, elemente këto që mund të na ofrojnë përparësi krahasuese, e që njëherit janë resurs kyç për rritje ekonomike.

## 4.2 Arsimi

Arsimi cilësor i fëmijëve është thelbësor për suksesin e shtetit dhe formimin e shoqërisë së zhvilluar si koncept i fuqishëm për zhvillimin e demokracisë, drejtësisë, barazisë dhe luftës kundër varfërisë. Për më tepër, e drejta për arsim është e drejtë fundamentale në kuadër të të drejtave të fëmijëve, e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe legjislacionin vendor në fuqi, me rol thelbësor në edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijëve.

Organizata e Kombeve të Bashkuara, në kuadër të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, arsimin e ka përcaktuar si objektiv (SDGs 4) të ndarë dhe të artikuluar në mënyrë thelbësore duke e vënë fokusin në arsimimin cilësor sipas të cilit, ‘pranimi i arsimit cilësor është thelbësor për përmirësimin e jetës së njerëzve dhe për zhvillim të qëndrueshëm’<sup>50</sup>.

Prandaj, Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm bëjnë thirrje për arsim cilësor për të gjithë, duke filluar nga vitet e para të jetës dhe duke siguruar arsimim të vazhdueshëm gjatë gjithë jetës<sup>51</sup>. Edhe pse sektori i arsimit është njëri ndër prioritetet qeveritare, shpenzimet e qeverisë në arsimin parauniversitar si përqindje e BPV mbeten ende të ulëta<sup>52</sup>.

<sup>48</sup> BB.2014. Rishikimi i financave publike të Kosovës- Politikat fiskale për një shtet të ri;

<sup>49</sup> BB.2007. “Nga e kuqja në të hirit: Tranzicioni i tretë i plakjes së popullsisë në europën lindore dhe në ish bashkimin sovjetik”;

<sup>50</sup> UN.2015. Sustainable Development Goals (SDGs) – Agenda 2030;

<sup>51</sup> UN.2015. Sustainable Development Goals (SDGs) – Agenda 2030;

<sup>52</sup> <http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/02/raport-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2016-17.pdf>

**Tabela 1.****Shpenzimet sipas niveleve në arsimin parauniversitar si përqindje e Bruto Produktit Vendor**

<b>Niveli i arsimit</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
Parashkollor	0.1%	0.1%
Parafillor	0.2%	0.2%
Fillor	1.3%	1.2%
I mesëm i ulët	1.2%	1.2%
I mesëm i lartë	0.9%	0.9%

Ndërsa, në kontekst të Republikës së Kosovës ku papunësia dhe varfëria bazuar në studime të ndryshme konsiderohen probleme më të mëdha, arsimi duhet të trajtohet si element bosht në përmirësimin radikal të mundësive për punësim dhe angazhim ekonomik si parakusht për përmirësim të jetesës dhe luftës kundër varfërisë. Nevoja e menjëhershme për fuqizimin e arsimit është për faktin se Kosova mund të përfitojë nga “dividenda demografike” që rrjedh nga popullsia e re, vetëm nëse e bën arsimin prioritet të parë edhe në shpenzimin publik<sup>53</sup>. Megjithatë, nëse kjo nuk bëhet, atëherë “dividenda demografike” mund të shndërrohet në “mallkim demografik”<sup>54</sup>.

Sipas të dhënave, në Republikën e Kosovës regjistrimi në arsimin fillor dhe atë të mesëm të ulët është po thuajse universal, përderisa është e nevojshme të shihen mundësitë e rritjes së qasjes në shkollë të mesme të larta. Konkretisht, shkalla neto e pjesëmarrjes në shkolla fillore dhe atë të mesme të ulët janë të larta, deri në 95 %, ndërsa shkalla neto e pjesëmarrjes në shkollën e mesme të lartë është 82 %<sup>55</sup>.


Të dhënat më të reja nga MASHT për vitin 2016/17, konfirmojnë se situata e përfshirjes së nxënësve në arsimin e mesëm të lartë mbetet ende më e ulët krahasuar me përfshirjen e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët .

<sup>53</sup> BB.2014. Rishikimi i financave publike të Kosovës- Politikat fiskale për një shtet të ri;

<sup>54</sup> Boughzala, M. 2013. “Youth Employment and Economic Transition in Tunisia”, Brookings Global Economy and Development Working Papers 57;

<sup>55</sup> ASK. 2015. Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë në Kosovë (MICS), 2013-2014.

**Figura (1) – Shkalla Bruto e Regjistrimit në arsimin parauniversitar sipas niveleve**  
Shënim: \* Fëmijet e moshës 0 - < 6 vjeç




Derisa situata e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor dhe parafillor sipas MASHT-it mbetet ende e ulët përkundër trendeve pozitive në vitet e fundit. Krahasuar me vitin 2014/15, kur Shkalla Bruto e Regjistrimit në edukimin parashkollor dhe parafillor (mosha 0 - < 6 vjeç) ishte 15.7%, në vitin 2016/17 është ngritur në 18%. Por të dhënat e zbërthyera sipas niveleve tregojnë se përfshirja e fëmijëve në nivelin parafillor (mosha 5- <6 vjeç) rezulton me ngritje të përfshirjes prej 79.6% në 87.6%, ndërsa në nivelin parashkollor dhe parafillor (mosha 3- <6 vjeç) mbetet 33.9%.

Për më tej, të dhënat në Kosovë tregojnë një nevojë për mundësi të shtuara dhe qasje në veçanti për arsimin parafillor dhe arsimin e mesëm të lartë, ku fëmijët janë më së shumti të privuar në fushën e arsimit në fëmijëri të hershme<sup>56</sup>. Përderisa rritja e cilësisë në arsim dhe plotësimi i mangësive që lidhen me performancën e nxënësve, mbetet një ndër sfidat më të mëdha të Qeverisë, duke pasur parasysh shkallën e pakënaqshme të kalueshmërisë së Kosovës në testin PISA të mbajtur në vitin 2015<sup>57</sup>. Veçanërisht, për faktin se arsimit cilësor është një e drejtë bazë e njeriut dhe një e mirë publike.

<sup>56</sup> ZKM. 2016. Karta raportuese – Raport mbi të drejtat e fëmijëve në Kosovë;

<sup>57</sup> Raport për arritjet e nxënësve të Kosovës në PISA 2015;

**Figura (2) Rezultatet e Kosovës në testin PISA, mesatarja e pikëve sipas Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (e njohur si OECD), pikët më të larta dhe pikët më të ulta të arritura në PISA 2015.**



**Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik - OECD, PISA Raporti për vitin 2015**

Përmirësimi i suksesit të nxënësve do të mundësojë forcimin e shkathtësive të fuqisë punëtore, e kjo për një periudhë afatgjatë do të mundësojë rritje më të madhe ekonomike dhe të ardhura më të larta<sup>58</sup>. Studimet theksojnë përfitimet e shumëfishta me parametra të lartë që rrjedhin nga arsimi, duke nënvizuar se çdo para e investuar në arsim cilësor do të kthehet 15 herë më shumë brenda dy dekadave. Duke vënë në dukje sfidat që rrjedhin si pasojë e cilësisë së ulët në arsim, të cilat, përveç tjerash, rrezikojnë stabilitetin, perspektivën për punësim të të rinjve në të ardhmen dhe zhvillimin ekonomik dhe kohezionin social të vendit.


### 4.3 Shëndetësia

Për një shoqëri progresive, kujdesi shëndetësor vlerësohet si e mirë publike dhe faktor qenësor për zhvillim, themelet e së cilës zënë vend parësorë në fëmijërinë e hershme, të karakterizuara me

<sup>58</sup> ZKM.2016. Strategjia Kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm 2016-2021;

gjendjen e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe shoqërore<sup>59</sup>. OKB në kuadër të tri objektivave të para për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimin e jetës së shëndetshme dhe promovimin e mirëqenies së fëmijëve i përcakton si thelbësore për zhvillim të qëndrueshëm të shtetit<sup>60</sup>. Mbijetesja dhe zhvillimi i shëndetshëm i fëmijëve konsiderohet e rëndësishme së veçantë edhe në kuadër të Konventës për të Drejtat e Fëmijës<sup>61</sup>, me dispozita të veçanta njeh të drejtën e fëmijëve për shëndet dhe kujdes shëndetësor. Përcaktuesit e shëndetit janë të shumtë dhe kompleks, të ndërlidhur ngushtë me faktorët politik, social, ekonomik dhe mënyrën e jetesës. Gjendje komplekse e sistemit shëndetësor reflektohet të jetë në Kosovë bazuar në të dhënat e studimeve të fundit, të cilat theksojnë se pavarësisht progresit të shënuar në disa tregues, ekzistojnë norma të larta të pabarazisë tek treguesit që i referohen sigurimit të mirëqenies dhe mbijetesës së fëmijëve dhe nënave, veçanërisht të grupeve më të cenuara. Progres, vërehet në rënien e shkallës së vdekshmërisë neonatale dhe fëmijëve nën 5 vjeç. Pavarësisht të arriturave, treguesit e shëndetësisë së fëmijëve në Kosovë janë ende më të varfrit në rajon, duke theksuar pabarazi në qasje edhe në cilësi të kujdesit<sup>62</sup>. Përderisa, shkaktarët e mortalitetit të lartë të foshnjave, janë të lidhur ngushtë me varfërinë, kequshqyeshmërinë dhe ambientin jo të shëndoshë.

**Figura (3) Shkallët e vdekshmërisë në fëmijëri të hershme, Kosovë, 2013-2014**



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2013-2014 MICS në Kosovë, 2015

<sup>59</sup> Andrija Stampar, Presidenti i Parë i Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 1946;


<sup>60</sup> UN. 2015. Sustainable Development Goals (SDGs) – Agenda 2030;

<sup>61</sup> UN. 1989. Konventa për të Drejtat e Fëmijës, shif nenet: 24, 23, 25, 33 dhe 39.

<sup>62</sup> UNICEF dhe OBSH. 2015. Ndërtimi i një ambienti të përshtatshëm politik për përmirësim të shëndetit të fëmijës, zhvillimit dhe mirëqenies në Kosovë. Një Përmbledhje Politike Bazuar në të Gjeturat e MICS në Kosovë;

Autoritetet globale shëndetësore, të ushqyerit e fëmijëve me qumësht gjiri e konsiderojnë si fundamentale për shëndetin e mirë të fëmijëve, duke e konsideruar mjet adekuat për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës. Të ushqyerit e fëmijës me qumësht gjiri gjeneron të mira që lidhen edhe me shëndetin e nënës dhe rritë përfitimet ekonomike duke ndikuar në uljen e shpenzimeve ndaj kujdesit shëndetësor. Sipas monitorimit të treguesve që lidhen me të ushqyerit me gji në Kosovë, 60% e fëmijëve ushqehen ekskluzivisht me qumësht gjiri deri më gjashtë muaj, ndërsa prej tyre 32% vazhdojnë të ushqehen me gji deri në moshën 2 vjeçare. Të dhëna këto që vënë në pah situatën e pafavorshme të fillimit të ushqyeshmërisë së fëmijëve, pasojat e së cilit mund të rrezikojnë zhvillimin njohës dhe uljen e produktivitetit e të rriturit. Prandaj, kujdes i veçantë duhet dhënë politikave promovuese për të ndikuar në rritjen e përqindjes së gji-dhënies, pasur parasysh aspirimin<sup>63</sup> ekonomik të Kosovës, kur dihet se rezultatet e koston në kthim të gji-dhënies janë të një periudhe shumë të shkurtër kohore, prej një viti<sup>64</sup>.

**Figura (4) Të ushqyerit me gji dhe të ushqyerit e foshnjave, Kosovë, 2013-2014**




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2013-2014 MICS në Kosovë, 2015

<sup>63</sup> ZKM.2016. Strategjia Kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm 2016-2021;

<sup>64</sup> UNICEF. 2016. Kosova në fazën e hershme të dividentës demografike – një mundësi me kohë të kufizuar.

Sistemi i imunizimit të fëmijëve është funksional, duke bërë të mundur imunizimin në shkallë të kënaqshme të fëmijëve, 79 % e fëmijëve rezultojnë të jenë plotësisht të vaksinuar.

**Figura (5) Përqindja e fëmijëve të moshës 24-35 muajsh të vaksinuar plotësisht dhe fëmijët që nuk janë vaksinuar fare tek popullata e përgjithshme 2013-2014**



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2013-2014 MICS në Kosovë, 2015

Raporte të ndryshme referuar sistemit shëndetësor, theksojnë se informacioni për shëndetin, treguesit e shëndetit dhe kujdesin shëndetësor, lidhja e tyre me tregues bazë sociale, në nivel individual dhe vendi, është i mangët, i pasaktë, dhe i fragmentarizuar. Për pasojë, mungesa e këtyre informacioneve vështirëson analizën e gjendjes shëndetësore të popullsisë, duke rezultuar që orientimi i politikave dhe vendimmarrja shpeshherë të jenë jokoherente. Fatmirësisht, është duke u punuar në shtrirjen dhe funksionalizimin e plotë të Sistemit të Informimit Shëndetësor<sup>65</sup> me anë të të cilit parashihet të ndërtohet sistemi unik dhe digjital shëndetësor duke mundësuar përmirësimin e funksionimit të sistemit shëndetësorë në tërësi.

Për të rritur cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore, që njëherit janë shtysë kryesore për përmirësimin e shëndetit në përgjithësi dhe ndër elementet më vendimtare për zhvillim ekonomik, resurset shëndetësore duhet të përqendrohen në kujdesin primar shëndetësor<sup>66</sup>. Sistemi shëndetësor duhet të orientojë veprimtarinë e vetë në parandalimin e sëmundjeve, në mënyrë që shoqëria të mos paguaj në formë të kostove të trajtimit dhe produktivitetit të humbur. Kjo qasje do të kontribonte krijimit të një cikli pozitiv duke mundësuar përmirësimin e shërbimeve shëndetësore

<sup>65</sup> Siç përkufizohet në Strategjinë për Sistemin e Informimit Shëndetësorë në Kosovë 2010-2012;

<sup>66</sup> Quilici, R., Smith, R., & Signorelli. C., (2015). Role of vaccination in economic growth, J Mark Access Health Policy;



bazike për të posalindurit, foshnjat dhe fëmijët, ushqyeshmërisë, shëndetit të fëmijës dhe nënës, arritjen e potencialit të plotë të tyre, me efekte domethënëse në përparimin e mendësisë së komunitetit për jetën e shëndetshme dhe përfitimeve të larta në zhvillimin ekonomik të vendit.

## 4.4 Mbrojtja dhe Përfshirja Sociale

Mbrojtja e fëmijëve fillon duke i larguar fëmijët nga varfëria.<sup>67</sup> Ata kanë të drejtë për të mbijetuar, për të qenë të sigurt, për t'u dëgjuar, për të marrë kujdesin e duhur dhe të rriten në një mjedis mbrojtës. Të jetuarit në varfëri të skajshme është në vetvete shkelje e të drejtave, e cila në masë të madhe përcakton rritjen dhe zhvillimin e dukurive negative si pasojë e së cilës fëmijët mund të jenë viktimat të fenomeneve të ndryshme negative, përfshirë: braktisjen e shkollës, shfrytëzimin, trafikimin, përfshirjen e fëmijëve në punë të rënda dhe të rrezikshme, delikuencën dhe sjelljet e tjera që bien ndesh me ligjin<sup>68</sup>.

Studimet theksojnë se përveç ndikimit mbi fëmijën, dështimi për t'iu siguruar fëmijëve ambient mbrojtës ka pasoja të mëdha, të menjëhershme dhe afatgjate në zhvillimin ekonomik të vendit. Asnjë shoqëri nuk ka pasur rezultat në zbutjen e varfërisë pa investim të madh dhe të qëndrueshëm për fëmijët<sup>69</sup>.

Me aprovimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs), liderët botërorë kanë vendosur një kurs transformues për të ardhmen e zhvillimit njerëzor, filluar me çrrënjosjen e varfërisë në të gjitha format e saj me fokus fëmijët, duke promovuar zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës. Këto objektiva kanë të integruar në vete, përveç tjerash, edhe parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës, që ndërlidhen me mbijetesën dhe zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijës.

Tutje, elementet thelbësore të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim, shkojnë përtej mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave themelore në kuptimin e përgjithshëm të fjalës, duke adresuar nevojën për angazhim deri tek mbrojtja individuale e fëmijës<sup>70</sup>. Republika e Kosovës konsiderohet të jetë një ndër vendet më të varfra në Europë, përderisa më të rrezikuarit nga varfëria janë fëmijët.

---


<sup>67</sup> OKB. 2000. Deklarata e Mijëvjeçarit;

<sup>68</sup> Bower. 2003. Ndërlidhje ndërmjet abuzimit të fëmijëve dhe varfërisë;


<sup>69</sup> UNICEF 2010. Varfëria e Fëmijëve në Kosovë;

<sup>70</sup> Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Europian dhe Komunitetit Europian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, 2015.

**Figura (6) Shkalla e varfërisë sipas vendbanimit për popullsinë e përgjithshme dhe fëmijët e moshës 0-18 vjeç (%) 2012-2015 Burimi: ABEF 2012 - 2015**




**Figura (7) Shkalla e varfërisë së skajshme sipas vendbanimit për popullsinë e përgjithshme dhe fëmijët e moshës 0-18 vjeç (%) 2012-2015. Burimi: ABEF 2012-2015**



Sipas të dhënave nëpër vite nuk vërehet ndryshim i theksuar në shkallën e varfërisë së skajshme tek fëmijët. Profili i varfërisë pasqyron imazhin e shtetit, ku gjasat e të qenit në varfëri lidhen fuqishëm me moshën, gjininë, nivelin arsimor dhe përkatësinë etnike. Nga kjo gjendje më të rrezikuarit janë fëmijët, veçanërisht fëmijët që jetojnë në vendet rurale dhe ata që jetojnë në familje me tre ose më shumë fëmijë<sup>71</sup>.

Mungesa e politikave efikase për të adresuar varfërinë në përputhje me nevojat e qytetarëve<sup>72</sup>, mungesa e skemës së beneficionit për fëmijë<sup>73</sup>, diskriminimi i fëmijëve nga moshë 5 - 18 vjeç për të përfituar nga skema e ndihmës sociale sipas kriterëve të përcaktuara në kategorinë II<sup>74</sup>, konsiderohen të jenë ndër faktorët kryesorë të përfshirjes së fëmijëve në punë të rënda dhe të rrezikshme, ndonëse kjo e fundit është e sanksionuar me ligj. Puna e fëmijëve përforcon ciklet e brezave të varfërisë dhe dëmton ekonominë kombëtare, të dhënat dëshmojnë përqindje të larët (11%<sup>75</sup>) të fëmijëve të përfshirë në punë.

**Figura (8) Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç që janë përfshirë në punë gjatë javës së fundit (të anketës), përqindja e atyre që punojnë në kushte të rrezikshme sipas vendbanimit tek popullata e përgjithshme dhe përqindja e fëmijëve që janë të përfshirë në punë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, 2013-2014**



Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2013-2014 MICS në Kosovë, 2015

<sup>71</sup> ZKM. 2014. "Raporti i Progresit për fëmijë IV"- Strategjia dhe Plani Nacional i veprimit për të Drejtat e fëmijëve 2009-2013;

<sup>72</sup> Ju lutem referojuni të gjeturave në: Raportin e BB, Rishikimi i financave publike të Kosovës- Politikat fiskale për një shtet të ri, 2014;

<sup>73</sup> Ju lutem referojuni të gjeturave në: Raportin e UNICEF, Varfëria e fëmijëve në Kosovë, 2010;

<sup>74</sup> Ligjin për Skemën e Ndhmës Sociale, Nr.2003/15;

<sup>75</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2015. Anketa e Treguesve të Shumëfishtë në Kosovë 2013-2014 (MICS);

Ka shumë arsye që i nxisin fëmijët drejt punës, sidoqoftë faktori më i rëndësishëm mbetet varfëria. Familjet e varfra i shtojnë fëmijët të punojnë në mënyrë që të shtojnë të ardhurat e tyre të pamjaftueshme<sup>76</sup>. Varfëria është njëkohësisht edhe shkak e edhe pasojë e punës së fëmijëve. Është patjetërsueshëm e rëndësishme priorizimi i masave mbrojtëse për t'iu ofruar fëmijëve përkrahjen e nevojshme dhe njëkohësisht për të parandaluar dhunën dhe për të promovuar disiplinën pozitive në prindërim dhe edukim<sup>77</sup>.

Masa të tilla mund të ndikojnë dukshëm në nxitjen e përparimit shoqërorë dhe qytetarisë demokratike në arritjen e vetëdijes më të lartë kolektive për të drejtat e fëmijëve për mbrojtje të barabartë nga rreziqet dhe pasojat e dhunës. Për të siguruar mbrojtje dhe përfshirje sociale të fëmijëve, analiza e situatës “Konteksti ligjor dhe fiskal si dhe kapacitetet e ofruesve të shërbimeve sociale në Kosovë”<sup>78</sup> rekomandon domosdoshmërinë për të rekrutuar staf të specializuar për mbrojtjen e fëmijëve në nivel lokal për të ofruar shërbime cilësore në përputhje me standardet minimale të cilësisë për shërbime sociale dhe politikat ekzistuese të orientuara drejt fëmijëve.

Tashmë kjo qasje është bërë konsensus në mesin e të gjitha shteteve palë në kuadër të OKB, që njëherit është edhe objektiva e 16 e synimeve për zhvillim të qëndrueshëm, të mobilizohen për promovimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse, për të siguruar qasje në drejtësi për të gjithë dhe për të ndërtuar institucione efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet<sup>79</sup>, në kuadër të së cilës shtetet zotohen t'i ndalin të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve.

Faktet dëshmojnë, se dhuna: pengon zhvillimin e fëmijëve, aftësitë e të mësuarit dhe performancën në shkollë, marrëdhëniet pozitive, nxitë ulje të vetëvlerësimit, shqetësim emocional dhe depresion, dhe, nganjëherë mund shpie tek rrezikimi dhe lëndimi i vetes.

Ndërsa, në Kosovë hulumtimet vënë në pah përdorimin e dhunës si mjet disiplinimi në të gjitha nivelet e shoqërisë, të dhënat dëshmojnë se 61% e fëmijëve kanë qenë subjekt i dhunës vetëm gjatë muajit të fundit.

---


<sup>76</sup> <http://www.aag-m.org/centrum/wp-content/uploads/2016/07/143-164.pdf>;

<sup>77</sup> Ju lutem referojuni: Rekomandimit Rec (2006) 19 të Komitetit të Ministrave për politikat në mbështetje të prindërimit pozitiv;

<sup>78</sup> Save the Children në Kosovë dhe Qendra Evropiane për hulumtim dhe politika të mirëqenies sociale (2018);

<sup>79</sup> UN.2015. Sustainable Development Goals (SDGs) – Agenda 2030;

**Figura (9) Përqindja e fëmijëve të moshës 1-14 vjeç sipas metodave disiplinore të përjetuara gjatë muajit të fundit (të anketës), Kosovë, 2013-2014**



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2013-2014 MICS në Kosovë, 2015

Pikëpamjet e vetë fëmijëve rreth adresimit të sfidave për realizimin e të drejtave të tyre në Kosovë, të nxjerra nga hulumtimi “Zëri Ynë”, vejnë në pah se 41.7% e fëmijëve të anketuar nuk dinë ku duhet të drejtohen kur u cenohen të drejtat ose trajtohen padrejtësisht, shumë fëmijë (50.3%) kanë thënë se nuk dinë se ku duhet të drejtohen kur kanë probleme në familje, 38.9% kanë deklaruar se nuk dinë ku duhet të drejtohen kur janë të përfshirë në dhunë, kërcënime ose krime të tjera, ndërsa 31.2% e fëmijëve kanë deklaruar se nuk dinë ku duhet të drejtohen kur kanë probleme psikologjike.

Kuptimi i varfërisë dhe privimeve të fëmijëve është kyç për zhvillimin e politikave që sigurojnë mirëqenien e fëmijëve dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Prandaj, Republika e Kosovës duhet të marrë masat e nevojshme që praktikisht ti bashkëngjitet përpjekjeve globale, për të larguar fëmijët nga varfëria, për të parandaluar dhunën, abuzimin, shfrytëzimin dhe neglizhimin nëpërmjet sistemeve të përmirësuara dhe të barabarta të mbrojtjes parandaluese dhe të fëmijëve.<sup>80</sup>

Treguesit e varfërisë, theksojnë nevojën e qartë për mbrojtje sociale. Prandaj, është e nevojshme krijimi i sistemit funksional për identifikimin më të mirë të të varfërve dhe të cenuarve, duke siguruar se skema e asistencës sociale ofron përkrahjen e domosdoshme për familjet për të dal nga varfëria<sup>81</sup>. Varfëria e fëmijëve dhe përjashtimi social mund të adresohen në mënyrë më efektive përmes

<sup>80</sup> UNICEF.2014. Plani Strategjik i UNICEF 2014-2017;

<sup>81</sup> BB.2014. Rishikimi i financave publike të Kosovës- Politikat fiskale për një shtet të ri;

sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve, që integrojnë me kujdes masat parandaluese, mbështetjen familjare, edukimin e hershëm të fëmijëve dhe kujdesin, shërbimet sociale, politikat e arsimit dhe strehimit<sup>82</sup>.

## 4.5 Pabarazia

Kur fëmijët nuk kanë një shans të drejtë në jetë, pabarazi të mëdha shfaqen në mes të atyre që kanë më shumë dhe atyre që kanë më së paku. Këto pabarazi barten nga brezi në brez, duke krijuar një rreth vicioz që çon në një botë të pabarabartë dhe të padrejtë, duke lënë pasojë të rëndësishme ekonomike, sociale dhe politike. Prandaj, investimi në fëmijë, sidomos më të varfërit dhe pabarabartët, është gjëja e drejtë dhe më e mençur për tu bërë. Dëshmitë tregojnë se kjo qasje ka perspektivë më të mirë dhe kosto efektive, sjell përfitime të shumta jo vetëm për fëmijën, por begati dhe qëndrueshmëri për familjen, komunitetin dhe zhvillimin e vendit, duke ju mundësuar fëmijëve të kenë një shancë të drejtë në jetë.

Investimi në fëmijët më të pafavorizuar është shpresa më e madhe e prishjes së ciklit të brezave të pabarazisë që ndikon miliarda njerëz<sup>83</sup>. Ky parim, fuqizohet tutje me vendimin e Parlamentit Evropian<sup>84</sup> për zvogëlimin e pabarazive me fokus të veçantë në varfërinë e fëmijës, duke e konsideruar si domosdoshmëri për kujdesin ndaj fëmijëve, si anëtarë më të cenuar në shoqëri. Domosdoshmëria e investimit në fëmijë, përveç tjerash, proklamohet edhe me Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Kartën Sociale Evropiane.

Traktate këto që kërkojnë garantimin e të drejtës së çdo fëmije për të gëzuar nivel të përshtatshëm të jetesës, mbrojtje sociale-ekonomike, zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të fëmijës. Përpjekjet globale për të ndërtuar një botë të barabartë janë bërë prioritet kyç i agjendës së Kombeve të Bashkuara, në kuadër të së cilës është përcaktuar një synim i dedikuar zvogëlimit të pabarazive (SDGs 10)<sup>85</sup>. Të dhënat dëshmojnë, se në Kosovë shumë fëmijë privohen nga të drejtat e tyre dhe diskriminohen në bazë të faktorëve që janë jashtë kontrollit të tyre, përfshirë: gjininë, aftësinë e kufizuar, përkatësinë etnike, statusin social-ekonomik dhe vendin e lindjes<sup>86</sup>.

---

<sup>82</sup> Këshilli i Evropës. 2016. Strategjia për të drejtat e fëmijëve 2016-2021;

<sup>83</sup> UNICEF. 2015. A fair chance for every child. UNICEF Executive Board Special Session on Equity Conference Room Paper;

<sup>84</sup> Parlamenti Evropian. Vendim 2014/2237;


<sup>85</sup> UN. 2015. Sustainable Development Goals (SDGs) – Agenda 2030;

<sup>86</sup> Ju lutem referojuni të gjeturave: Varfëria dhe privimi në mesin e fëmijëve me përdorimin e Analizës së Privimeve të Shumëfishta (MODA), UNICEF, 2015;

**Figura (10):** Analizimi i privimeve për fëmijët e moshës 0 – 11 muajsh në fusha të ndryshme.

Privimi shumëdimensional për fëmijët e moshës 0-11 muajsh në ushqyeshmëri, shëndetësi dhe mbrojtje të fëmijëve (Burimi: Kalkuimet e autorit, Kosovë MICS 2013-2014)

Privimi shumëdimensional për fëmijët e moshës 0-11 muajsh në ushqyeshmëri, mbrojtje nga dhuna dhe sanitari (Burimi: Kalkuimet e autorit, Kosovë MICS 2013-2014)



Sipas analizës së privimeve të shumëfishta në Kosovë, vërehet se fëmijët e vegjël kanë më shumë gjasa të privohen nga të drejtat e tyre në dimensione të shumëfishta dhe në të njëjtën kohë se sa fëmijët më të rritur. Cenueshmëria e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi, por në veçanti nën moshën 5 vjeçare, duhet të trajtohen me kujdes të veçantë. Literatura dëshmon se gjurmët e boshllëqeve të krijuara nga privimet në fëmijërinë e hershme, nuk mund të rifitohen apo përmbushen më vonë. Ngase, gjysma e potencialit të inteligjencës së një personi zhvillohet deri në moshën katër vjeçare dhe se nxitjet në fëmijërinë e hershme mund të kenë një efekt të përhershëm në kapacitetin intelektual, personalitet dhe sjellje shoqërore. Në mënyrë që Kosova të përfitojë dhe të maksimizojë dividendin demografik, nevoja për investime në kapitalin njerëzor është vendimtare<sup>87</sup>.

Të gjithë fëmijët meritojnë mundësinë për të qenë të lumtur dhe të shëndetshme, për të eksploruar botën e tyre në mënyrë të sigurt dhe të arrijnë potencialin e tyre të plotë<sup>88</sup>. Investimi në fëmijë është rruga e vetme për ti dhënë fund varfërisë dhe krijimit të mundësive të barabarta, madje duke

<sup>87</sup> UNICEF. 2016. Kosova në fazën e hershme të dividendës demografike – një mundësi me kohë të kufizuar.

<sup>88</sup> [www.unicef.org/equity/](http://www.unicef.org/equity/)

adresuar pabarazi që shpesh shfaqen edhe para se fëmija të lind. Vetëm teksa i afrohemi realizimit të të drejtave të të gjithë fëmijëve, shtetet do të mund t'i afrohen qëllimeve të tyre përkatëse për zhvillim, mirëqenie dhe paqe<sup>89</sup>.

## 5.0 Objektivat Strategjike dhe objektivat specifike

---

*Jean Piaget besonte se:*

*“fëmijët janë mendimtarë aktiv, të cilët përpiqen në mënyrë konstante të ndërtojnë një të kuptuar të përparuar të botës”*

---

Në themel të reformimit të sistemit të mbrojtjes sociale në vazhdimësi duhet të punohet që të instalohet filozofia e inkurajimit të politikave sociale parandaluese, duke krijuar kështu kushte për zhvillimin e lirë dhe plotësimin e nevojave të jetesë e zhvillim për të gjithë fëmijët.

Që të arrihet synim i Strategjisë janë caktuar objektivat strategjike me objektivat specifike, si:

### 5.1 Objektiva strategjike #1:

#### **Përmirësimi i qeverisjes së mirë për realizimin e të drejtave të fëmijëve**

Qeverisja e mirë, përcakton se sa proceset e punës dhe praktikat ditore institucionale janë efektive dhe efikase në arritjen e barazisë, transparencës, pjesëmarrjes, llogaridhënies dhe zbatimit të ligjit. Në të njëjtën kohë, testi kryesor i qeverisjes së mirë është shkalla e shtrirjes së saj në kontekst të promovimit dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve. Përveç vlerës së brendshme institucionale, qeverisja e mirë është e dobishme për një gamë të gjerë të rezultateve zhvillimore, duke përfshirë çrrënjosjen e varfërisë, zvogëlimin e pabarazive, rritjen ekonomike dhe zhvillimin më të gjerë shoqëror. Të drejtat e fëmijëve nuk mund të realizohen plotësisht pa mekanizma qeverisës efektiv, transparent dhe të përgjegjshëm. Prandaj, arritja e objektivës së parë strategjike, konsiderohet se është thelbësore në realizimin e të drejtave të fëmijëve, arritjen në mënyrë efektive të një game të gjerë të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe krijimin e fuqizimin e sistemit dhe

---

<sup>89</sup> Anthony Lake. Drejtor ekzekutiv i UNICEF, 2014;



mekanizmit institucional për të drejtat e fëmijës, në kontekst të avancimit të monitorimit, vlerësimit dhe zbatimit të politikave dhe kornizës ligjore.

**Për arritjen/përmbushjen e objektivës strategjike janë paraparë këto objektiva specifike:**

Objektiva specifike 1.1	Objektiva specifike 1.2	Objektiva specifike 1.3	Objektiva specifike 1.4	Objektiva specifike 1.5
Harmonizimi i kornizës ligjore për të drejtat e fëmijëve me standarde ndërkombëtare dhe përmirësimi i zbatimit;	Funksionalizimi i mekanizmave për të drejtat e fëmijëve në nivel qendror;	Fuqizimi i sistemit të ankesave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;	Prioritizimi në ndarjen dhe alokimin e buxhetit për realizimin e të drejtave të fëmijë;	Përmirësimi i Avancimi i monitorimit të të drejtave të fëmijës;

## 5.2 Objektiva strategjike #2:

### **Përmirësimi i qeverisjes lokale për realizimin e të drejtave të fëmijëve**

Me qasje dhe synim pothuajse të njëjtë me objektivën e parë strategjike, objektiva e dytë strategjike kërkon që në kuadër të agjendës zhvillimore të qeverisjes lokale të drejtat e fëmijëve të prioritetohen, duke synuar përmirësimin e jetës së fëmijëve brenda juridiksionit të tyre në kontekst të realizimit të të drejtave të fëmijëve në përputhje me obligimet që rrjedhën nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës, korniza ligjore për të drejtat e fëmijëve, politikat dhe strategjitë nacionale. Praktikiisht kërkon që nevojat, prioritetet dhe të drejtat e fëmijëve të jenë pjesë integrale e politikave, programeve dhe vendimeve publike. Duke i dhënë vëmendje të veçantë alokimit të buxhetit për fëmijë, ndërmarrjes së një varg masash për rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara, harmonizimit të politikave dhe veprimeve me nivelin qendror, ristrukturimin dhe funksionalizimin e mekanizmave për zbatim dhe monitorim të të drejtave të fëmijës në nivel lokal. **Për arritjen/përmbushjen e objektivës strategjike janë paraparë këto objektiva specifike:**

Objektiva specifike 2.1	Objektiva specifike 2.2
Harmonizimi i politikave, ristrukturimi dhe funksionalizimi i mekanizmave për zbatimin dhe monitorimin e të drejtave të fëmijës në nivel lokal;	Përmirësimi i mbulueshmërisë dhe cilësisë në ofrimin e shërbimeve për fëmijë;

## 5.3 Objektiva Strategjike #3: Përfshirja dhe fuqizimi i fëmijëve në vendimmarrje

Pjesëmarrja e fëmijëve në procese vendimmarrëse është më shumë sesa thjesht ti pyesim fëmijët për idetë dhe pikëpamjet e tyre. Procesi i përfshirjes së fëmijëve në vendimmarrje ka të bëjë me dëgjimin e tyre, duke i marrë me seriozitet dhe duke i kthyer idetë dhe sugjerimet e tyre në realitet.

Përfshirja dhe fuqizimi i fëmijëve në procese vendimmarrëse është e rëndësishë së veçantë për shumë arsye, ju jep mundësi për të shprehë përvojat, idetë dhe vlerësimet për vendimet që i prekin ata, mësojnë aftësi të reja, argëtohen dhe zhvillojnë lidhje më të ngushtë me komunitetin dhe institucionet shtetërore, Prandaj, me anë të kësaj objektive strategjike parashihen të fuqizohen veprimet të cilat kanë të bëjnë me të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar dhe të kenë rol në marrjen e të gjitha vendimeve që i prekin ata, si në: familje, shkollë, komunitet, institucione lokale dhe qendrore.

Në këtë drejtim parashihen të sigurohen mekanizma institucional të qëndrueshëm për pjesëmarrjen e fëmijëve duke ndikuar në ndryshimin e qëndrimeve dhe praktikave të konsultimit të fëmijëve. Njëkohësisht, zhvillimin e vlerave kulturore dhe qytetare të fëmijët, duke ndikuar në të kuptuarit e mirëfilltë të përgjegjësive të tyre për të kontribuar në shoqëri si qytetarë të ndershëm dhe të përgjegjshëm.

**Për arritjen/përbushjen e objektivës strategjike janë paraparë këto objektiva specifike:**

Objektiva specifike 3.1	Objektiva specifike 3.2	Objektiva specifike 3.3
Pjesëmarrja e fëmijëve në vendimmarrje në nivel qendror dhe lokal sigurohet përmes mekanizmave të qëndrueshëm;	Sistemi i arsimit i fuqizuar në zhvillimin e kompetencave të fëmijëve për pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje;	Fuqizimi i fëmijëve për zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive për monitorim dhe raportim për situatën e të drejtave të fëmijëve;

## 5.4 Objektiva Strategjike #4:

### Gjithëpërfshirja e fëmijëve në shërbime të integruara për edukim dhe zhvillim në fëmijërinë e hershme

Kontributi kryesor në zhvillimin e kapitalit njerëzor është zhvillimi në fëmijërinë e hershme. Vitet e para, në fëmijëri formojnë njeriun, edukimi në këtë periudhë ndikon në përbërjen e bazës së kapacitetit të mëvonshëm të fëmijës për të mësuar, të sjelljes në shoqëri, dhe personalitetit.

Duke iu ofruar edukimin, përkrahjen dhe kujdesin e mjaftueshëm, shëndetin, mirëqenien e ushqimin e duhur, fëmija ka më shumë gjasa të jetë i suksesshëm në shkollë, të integrohet në shoqëri dhe të formohet si qytetar i përgjegjshëm dhe produktiv. Kufizimi i këtyre mundësive ndikon në zhvillimin e aftësive dhe cilësisë së jetës të fëmijëve, për rrjedhojë nuk arrijnë të zhvillojnë potencialin e plotë të tyre. Prandaj, paradigma e zhvillimit kombëtar, ekonomik dhe shoqëror në shtetet perëndimore është duke kaluar nga progresi i pastër ekonomik në mirëqenien njerëzore. Objektiva strategjike synon të vendosë hapat e duhur që do të sigurojnë qëndrueshmëri dhe investim cilësor në programet e edukimit të hershëm, duke ndikuar në përmirësimin e kualitetit të jetës dhe uljen e barrës së kosotos joproduktive.

Për arritjen/përmirësimin e objektivës strategjike janë paraparë këto objektiva specifike:

Objektiva specifike 4	Objektiva specifike 4.2	Objektiva specifike 4.3
Prioritizimi i Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme nga Këshilli për të Drejtat e Fëmijës;	Rritja e investimit dhe sigurimi i përfshirjes të fëmijëve në arsim parashkollor, parafillor duke përfshirë edhe programet alternative;	Përmirësimi i sistemit të sigurimit të cilësisë së shërbimeve në Zhvillimin në Fëmijërinë e Hershme;

## 5.5 Objektiva Strategjike #5:

### Përmirësimi i shëndetit, mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve për arritjen e potencialit të tyre të plotë

Çdo fëmijë ka të drejtë të arrijë potencialin e plotë. Që fëmijët të gëzojnë këtë të drejtë është e nevojshme të krijohet mjedis më i fuqishëm mbrojtës duke siguruar që shërbimet për mbrojtjen e

fëmijëve të jenë të orientuara me fëmijën në qendër. Ndonëse mbrojtja është e drejtë e çdo fëmije, disa fëmijë në baza ditore vazhdojnë të privohen nga të drejtat e garantuara përfshirë fëmijët me aftësoi të kufizuara, fëmijët e përfshirë në punë të rënda dhe të rrezikshme, fëmijët viktime dhe dëshmitarë të dhunës, fëmijët në konflikt dhe në kontakt me ligjin. Prandaj objektiva strategjike parasheh prioritizimin e masave mbrojtëse për t'iu ofruar fëmijëve përkrahjen e nevojshme, përmes investimit të duhur të sigurohet barazia dhe gjithëpërfshirja për të gjitha grupet e fëmijëve pa dallim, njëkohësisht veprime konkrete me qasje parandaluese dhe reaguese duke adresuar përgjegjësit e të gjithë anëtarëve të shoqërisë, në kontekst të promovimit të disiplinës jo të dhunshme, edukimit pozitiv dhe zhvillimit të shëndetshëm.

Mbrojtja e fëmijëve mund të arrihet vetëm atëherë kur të drejtat e fëmijës respektohen nga të gjithë, prindërit, kujdestarët ligjorë, anëtarët e familjes dhe komunitetit; profesionistë që punojnë në institucione publike dhe private. Prandaj, objektiva parasheh mobilizim të shoqërisë drejtë ngritjes së vetëdijes shoqërore ndaj dëmeve që shkakton dhuna ndaj fëmijëve dhe nevojën që të punohet në vazhdimësi për parandalimin dhe sanksionimin e saj, duke synuar ndërrimin e qëndrimeve ndaj fenomenit të dhunës.

Në këtë kontekst, synohet nxitja e përparimit shoqërorë dhe qytetarisë demokratike në arritjen e vetëdijes më të lartë kolektive për të drejtat e fëmijëve, me ndihmën e përmbushjes së këtyre objektivave specifike:

<b>Objektiva specifike 5.1</b>	<b>Objektiva specifike 5.2</b>	<b>Objektiva specifike 5.3</b>	<b>Objektiva specifike 5.4</b>	<b>Objektiva specifike 5.5</b>
Parandalimi, mbrojtja dhe riintegrimi i fëmijëve të përfshirë në punë të rënda dhe të rrezikshme;	Fuqizimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të integruara për fëmijë me aftësi të kufizuara;	Parandalimi dhe mbrojtja e fëmijëve nga dhuna dhe dukuritë negative	Sigurimi i qasjes në drejtësi për fëmijë dhe parandalimi i delikuencës;	Vetëdijesimi i popullatës për prindërim më të mirë;

## 6.0 Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit

---

*“Mundësia për të ekzekutuar strategjinë është më e rëndësishme se vetë cilësia e strategjisë”*

**Robert S. Kaplan**

---

Synimi kryesor i institucioneve të Republikës së Kosovës, pa dyshim se është zbatimi në tërësi i dokumentit strategjik, proces ky që do të përcaktohet nga realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit nëpër vite. Procesi i zbatimit të strategjisë, do të jetë një proces i realizimit të synimeve strategjike dhe objektivave të saj.

Procesi i zbatimit të masave dhe politikave të parashikuara në Strategjinë për të Drejtat e Fëmijëve kanë një shtrirje të kohë gjatësisë prej 5 viteve, që përfshin vitet 2019-2023. Ndërsa, për zbatimin e objektivave strategjike, hartohet Plani i Veprimit 3 vjeçarë në të cilat përcaktohen objektivat specifike, aktivitetet konkrete karshi institucioneve përgjegjëse dhe mbështetëse për zbatimin e tyre, treguesit SMART, gjendja ekzistuese, synimi/targeti, burimet financiare, të cilat duhet përlllogaritur duke iu referuar buxhetit të paraparë në kornizën afatmesme të shpenzimeve (KASH) si dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre. Gjithashtu, në përlllogaritjen e nevojave financiare duhet të merren në konsideratë edhe projektet me financim nga donatorët, në vijim ose të planifikuara, sipas fushave specifike.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit do të jetë përgjegjëse për koordinimin dhe bashkërendimin e punës përgjatë hartimit të Planit të Veprimit në bashkëpunim me të gjithë akterët relevantë. Obligohen të gjitha institucionet mandatore shtetërore, në nivel qendrorë dhe lokal, për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve. Po ashtu, institucionet përgjegjëse duhet të sigurojnë përfshirjen e këtyre politikave strategjike në kuadër të planeve vjetore të punës së tyre.

Përderisa, monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponentë kryesor e procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimit e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet. Procesi i monitorimit do të realizohet nga Zyra për

Qeverisje të Mirë/Zyra e kryeministrit në bashkëpunim me institucionet qeveritare përgjegjëse për zbatim të dokumentit strategjikë dhe me pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesit.

Monitorimi do të jetë proces kyç për ofrimin e informatave të nevojshme për qëllime llogaridhënieje, ai nuk do të jetë efektiv nëse nuk ndërmerren veprime ndaj asaj që është vlerësuar dhe raportuar. Andaj, çdo fund vit Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me mekanizmat përgjegjës të përcaktuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, do të hartojë raportin vjetor i cili duhet të përmbajë vlerësimin e aktiviteteve më të suksesshme dhe në përgjithësi përmbushjen e qëllimeve të strategjisë, identifikimin e sfidave dhe vështirësive të hasura gjatë procesit të zbatimit si dhe ofrimin e rekomandimeve konkrete për mënjanimin e pengesave të paraqitura përgjatë procesit të përmbushjes së objektivave specifike dhe atyre strategjike.

**Për monitorimin e zbatimit të dokumentit strategjik dhe efektivitetit të saj janë esenciale:**

I	për të siguruar që po arrihen qëllimet,
II	për të monitoruar kontributet e investuara dhe aktivitetet,
III	për të siguruar nëse implementimi po shkon sipas rrjedhës së përcaktuar,
IV	për të paralajmëruar institucionet përgjegjëse për problemet/ngecjet ose problemet potenciale para se situata të bëhet kritike,
V	për të sugjeruar veprime korigjuese ose për të rishikuar strategjinë në bazë të përvojës së fituar.

Duke monitoruar strategjinë dhe indikatorët e performancës, institucionet do të jenë në gjendje të krijojnë një pasqyrë mbi gjendjen, d.m.th. në ç'pikë ndodhet strategjia drejt arritjes së qëllimeve të përcaktuara, nxjerrjes së mësimave, marrjes së masave korigjuese, dhe, nëse është e mundur, proceseve rishqyrtuese të saj. Është parë që vlerësimi është më i dobishëm kur nxirren mësim nga procesi i zhvilluar, të cilat pastaj shfrytëzohen për procese në të ardhmen.

Prandaj, gjatë vlerësimit të efektivitetit të strategjisë një gjë të tillë duhet pasur parasysh. Në këtë kuptim, strategjia do të jetë një dokument dinamik, që do t'i përshtatet ndryshimit të objektivave, rrethanave dhe përvojës së fituar.

## 6.1 Mekanizmat zbatues

Të gjitha institucionet qeveritare, qendrore dhe lokale, obligohen të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin të detyrimeve të përcaktuara në “Strategjinë për të Drejtat e Fëmijëve” dhe Planin e Veprimit për zbatimin e strategjisë nëpër vite, në përputhje me përgjegjësitë dhe mandatin ligjor të tyre.

## 6.2 Mekanizmat monitorues

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Strategji si dhe aktiviteteve që do të përcaktohen në Plan të Veprimit.

Për ta vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve, apo anasjelltas, mekanizmat për të Drejtat e Fëmijët siç parashihen në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës do të raportojnë përparimin në jetësimin e zbatimit të dokumentit strategjik në baza vjetore.

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë do të ketë rolin udhëheqës për të bashkërenduar punën, mbikëqyrur dhe vlerësuar procesin e zbatimit të Planit të Veprimit, në të njëjtën kohë do të shërbejë si Sekretariat, dhe në baza periodike çdo vit do të raportojë direkt Komitetit Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës. Me ç’rast, çdo fund vit ZQM/ZKM në bashkëpunim me Këshillin për të Drejtat e Fëmijës janë të obliguar të hartojnë “Raportin e Progresit” mbi zbatimin e dokumentit strategjik, i cili do të jetë treguesi kyç për të pasqyruar qartë progresin apo regresin mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit. Ndërsa, varësisht nga rekomandimet e dala nga “Raporti i Progresit”, institucionet përgjegjëse janë të obliguara të shqyrtojnë dhe të zbatojnë ato në bazë sa më optimale të mundshme.

Njëkohësisht, institucionet qeveritare, në nivel qendror dhe lokal, do të raportojnë në bazë të nevojave dhe kërkesës të drejtuar nga ZQM/ZKM, në mënyrë që raportet institucionale të jenë të unifikuara dhe gjithëpërfshirëse.

Këshillat e Nxënësave, Këshillat e Prindërve, organizatat jo-qeveritare, inkurajohen që në partneritet me institucionet qeveritare të marrin pjesë në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e dokumentit strategjik.

Në çdo nismë të realizuar nga institucionet shtetërore, shoqëria civile dhe OJQ-të do të inkurajohen të paraqesin edhe raportet e tyre vëzhguese mbi zbatueshmërinë e dokumentit strategjik apo raportet e tyre mbi aktivitetet e realizuara që lidhen me projektet dhe programet për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

## 7.0 Ndikimi buxhetor dhe zbatimi i strategjisë

Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve ka një kosto totale të zbatimit prej **1,364,499.96** Euro për tri vite të zbatimit 2019-2021. Pjesa më e madhe e koston (rreth 90% e buxhetit) do të përdoret për shpenzimet rrjedhëse që lidhen me ngritjen e kapaciteteve, rregullimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit që kanë të bëjë me të drejtat e fëmijëve.

Tabela 1 jep një përmbledhje të buxhetit për zbatimin e Planit sipas dhe viteve, ndërsa kjo bazohet në kalkulime të detajuara të shpenzimeve për secilin objektivë të planifikuar, ndërsa tabela 2 jep një përmbledhje të buxhetit për zbatimin e Planit sipas burimeve të financimit.

Zbatimi i planit të veprimit për 3 vitet e para do të kërkojë mjete financiare siç tregohet në tabelën më poshtë në milionë euro (KT- Buxheti i përgjithshëm për Planin e Veprimit, KR- kostot rrjedhëse, K – kapital kapitale, SG – subvencionet dhe garantët).

**Tabela 1.**

Përmbledhja e buxhetit sipas objektivave dhe viteve

Objektivat Strategjike	2019				2020				2021			
	KT	KR	K	SG	KT	KR	K	SG	KT	KR	K	SG
Përmirësimi i qeverisjes së mirë për realizimin e të drejtave të fëmijëve;	43,490	43,490	0	23,000	32,155	32,155	0	15,400	60,565	40,565	20,000	32,000
Përmirësimi i qeverisjes lokale për realizimin e të drejtave të fëmijëve.	61,900	61,900	0	40,000	79,260	79,260	0	38,000	63,260	63,260	0	35,000



Përfshirja dhe fuqizimi i fëmijëve në vendimmarrje.	91,566.66	91,566.66	0	60,000	87,566.66	87,566.66	0	60,000	81,566.66	81,566.66	0	55,000
Gjithëpërfshirja e fëmijëve në shërbime të integruara për edukim dhe zhvillim në fëmijërinë e hershme.	51,890	51,890	0	22,000	28,390	28,390	0	12,000	26,890	26,890	0	13,000
Përmirësimi i shëndetit, mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve për arritjen e potencialit të tyre të plotë.	274,666.66	244,666.66	30,000	135,000	237,166.66	194,166.66	43,000	130,000	184,166.66	171,166.66	13,000	115,000
<b>Totali:</b>	<b>523,513.32</b>				<b>465,238.32</b>				<b>416,448.32</b>			
<b>Nën-totali 2019-2021:</b>	<b>1,405,199.96</b>											

Tabela 2.

Struktura e shpenzimeve sipas viteve të planifikuara në plan të veprimit dhe burimit të financimit

Vitet	Shpenzime totale		
	BRK	Donatorët	Total:
2019	243,513.32	280,000	<b>523,513.32</b>
2020	205,338.32	259,900	<b>465,238.32</b>
2021	163,448.32	253,000	<b>416,448.32</b>
<b>Total:</b>	<b>612,299.96</b>	<b>792,900.00</b>	<b>1,405,199.96</b>

Tabela 3.

Struktura e shpenzimeve për dy vitet e fundit të strategjisë dhe burimit të financimit

Vitet	Shpenzime totale		
	BRK	Donatorët	Total:
2022	160,313.12	220,000	380,313.12
2023	80,122.22	124,700	204,822.22
<b>Total:</b>	<b>240,435.34</b>	<b>344,700</b>	<b>585,135.34</b>

## 8.0 Ndërlidhja e Strategjisë për të Drejtat e Femijëve me SDG (Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm)

	SDG Qëllimi	SDG caku	SDG Treguesit	Treguesit e Objektivave Strategjike  (Strategjisë për të Drejtat e Femijëve)	Treguesit e Objektivat Specifike  (Strategjisë për të Drejtat e Femijëve)
1	Qëllimi 1: Zero varfëri	1.2 Deri në vitin 2030, zvogëlimi të paktën gjysmën e përqindjes së burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri në të gjitha përmasat e saj sipas përkufizimev	1.2.1 Përqindja e popullsisë që jeton nën vijën kombëtare të varfërisë, sipas gjinisë dhe moshës <sup>1</sup>	1.2 Shkalla e varfërisë tek fëmijët (mosha 0-18 vjeç)	

	<b>SDG Qëllimi</b>	<b>SDG caku</b>	<b>SDG Treguesit</b>	<b>Treguesit e Objektivave Strategjike</b> <b>(Strategjisë për të Drejtat e Femijëve)</b>	<b>Treguesit e Objektivat Specifike</b> <b>(Strategjisë për të Drejtat e Femijëve)</b>
		e kombëtare <sup>1</sup>			
2	Qëllimi 4: Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovim i mundësive të nxënitorit gjatë gjithë jetës për të gjithë	4.2 Deri në vitin 2030, sigurohuni që të gjitha vajzat dhe djemtë të kenë qasje në zhvillimin e cilësisë së hershme të fëmijëve, kujdesin dhe arsimin parashkollor, në mënyrë që ata të jenë gati për arsimin fillor	4.2.1 Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeçare të cilët janë në zhvillim e sipër në shëndetësi, mësim dhe mirëqenie psikosociale, sipas gjinisë	4.2 Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muajsh që në aspektin zhvillimor janë në hap me së paku tre nga katër kriteret vijuese: shkrim-lexim dhe numërim, aspektifizik, social-emocional dhe të mësuarit.	
			4.2.2 Shkalla e pjesëmarrjes në të mësuarit e organizuar (një vit para moshës zyrtare të hyrjes fillestare), sipas gjinisë	4.1. Shkala Bruto e Regjistrimit në arsimin parashkollor dhe parafillor (mosha 3-<6 vjeç);	
		4.c Deri në vitin 2030, rritet ndjeshëm furnizimi i mësuesve të kualifikuar, duke	4.c.1 Proporcioni i mësuesve në: (a) parafillor; (b) primar; (c) niveli i mesëm i ulët; dhe (d) arsimin e mesëm të		4.3.2 Nr. i stafit të trajnuar për edukimin parashkollor;

	SDG Qëllimi	SDG caku	SDG Treguesit	Treguesit e Objektivave Strategjike  (Strategjisë për të Drejtat e Femijëve)	Treguesit e Objektivat Specifike  (Strategjisë për të Drejtat e Femijëve)
		përfshirë bashkëpunim in ndërkombëtar për trajnimin e mësuesve në vendet në zhvillim, veçanërisht vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet e vogla në zhvillim të ishullit.	lartë i cili ka marrë të paktën trajnimin minimal të organizuar të mësuesve (p.sh. trajnimin pedagogjik) para shërbimit ose në shërbim të kërkuar për mësime në nivelin përkatës në një vend të caktuar		
		4.5 Deri në vitin 2030, eliminimi i pabarazive gjinore në arsim dhe sigurimi i qasjes së barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe formimit profesional për të prekurit, përfshirë personat me	4.5.1 Indekset e barazisë (femrat / meshkujt, rurale / urbane, kuadri i poshtëm / pasuri i lartë dhe të tjerë si statusi i aftësisë së kufizuar, popujt indigjenë dhe konfliktet e ndikuara, pasi të dhënat bëhen të disponueshme) për të gjithë treguesit e arsimit në këtë		4.2.1 Nr. i qendrave me bazë në komunitet  4.2.2 Nr. i fëmijëve me aftësi të kufizuara të përfshirë në qendrat burimore sipas nivelit arsimor  4.2.3 Nr. i fëmijëve nga komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptasë

	<b>SDG Qëllimi</b>	<b>SDG caku</b>	<b>SDG Treguesit</b>	<b>Treguesit e Objektivave Strategjike</b> <b>(Strategjisë për të Drejtat e Femijëve)</b>	<b>Treguesit e Objektivat Specifike</b> <b>(Strategjisë për të Drejtat e Femijëve)</b>
		aftësi të kufizuara, popujt indigjenë dhe fëmijët në situata të cenueshme	listë që mund të ndahen		të përfshirë në arsim parashkollor;
3	Qëllimi 8. Nxitja e rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë	8.7 Të marrin masa të menjëhershme dhe efektive për të zhdukur punën e detyruar, për t'i dhënë fund skllavërisë moderne dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe për të siguruar ndalimin dhe eliminimin e formave më të këqia të punës së fëmijëve,	8.7.1 Proporcioni dhe numri i fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të angazhuar në punën e fëmijëve, sipas gjinisë dhe moshës.	5.1 Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të përfshirë në punë.	

	<b>SDG Qëllimi</b>	<b>SDG caku</b>	<b>SDG Treguesit</b>	<b>Treguesit e Objektivave Strategjike</b> <b>(Strategjisë për të Drejtat e Femijëve)</b>	<b>Treguesit e Objektivat Specifike</b> <b>(Strategjisë për të Drejtat e Femijëve)</b>
		duke përfshirë rekrutimin dhe përdorimin e ushtarëve fëmijë dhe deri në vitin 2025 në të gjitha format e tij.			
4	Qëllimi 16. Promovim i i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfs hirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfs hirëse në	16.2 Shfuqizimi, shfrytëzimi, trafikimi dhe të gjitha format e dhunës dhe torturës ndaj fëmijëve  16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente	16.2.1 Përqindja e fëmijëve të moshës 1-17 vjeç që kanë përjetuar ndonjë ndëshkim fizik dhe / ose agresion psikologjik nga kujdestarët gjatë muajit të kaluar  16.6.1 Shpenzimet e qeverisë primare në përpjesëtim me buxhetin e miratuar origjinal, sipas sektorëve (ose	5.2 Përqindja e fëmijëve të moshës 1-14 vjeç që kanë përjetura dhunë psikologjike apo fizike gjatë muajit të fundit	

	<b>SDG Qëllimi</b>	<b>SDG caku</b>	<b>SDG Treguesit</b>	<b>Treguesit e Objektivave Strategjike</b> <b>(Strategjisë për të Drejtat e Femijëve)</b>	<b>Treguesit e Objektivat Specifike</b> <b>(Strategjisë për të Drejtat e Femijëve)</b>
	të gjitha nivelet	në të gjitha nivelet	me kodet buxhetore ose të ngjashme)		
		16.9 Deri në vitin 2030, të sigurojë identitetin ligjor për të gjithë, përfshirë regjistrimin e lindjes	16.9.1 Përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç, lindjet e të cilëve janë regjistruar në një autoritet civil, sipas moshës	1.1 Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeçare lindjet e të cilëve janë raportuar si të regjistruara	;





